



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Janar 2022

Nr: 12

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN PËR ZGJEDHJET  
E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE PËR DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE,  
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 99, pikat 1 dhe 2, nenit 100, pika 1, shkronjat “a”, b”, ”ç” e “d” dhe nenin 104, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022, të përdoren materialet zgjedhore si më poshtë:
  - a) Materialet zgjedhore të cilat ndodhen gjendje në magazinën e KQZ-së, si vijon:
    - i) Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore, sipas modelit dhe specifikimeve teknike të lidhjes 1, pjesët I dhe II, të përcaktuar me vendim nr. 36, datë 17 Dhjetor 2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
    - ii) Kodet e sigurisë dhe kodet rezervë për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, sipas modelit të miratuara me vendim nr. 8, datë 12 Janar 2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  - b) Boja timbruese, sipas modelit të lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  - c) Dhomat e fshehta, sipas modelit të lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 26 Janar 2022  
Nr. 12

“Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022”

## LIDHJA 1

1. Të miratojë specifikimet e lëndës së posaçme për timbrimin e zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022, si më poshtë:
  - a) e dukshme me shikim të lirë;
  - b) nuk hiqet për jo më pak se 24 orë nga koha e timbrimit;
  - c) me efekt të menjëhershëm;
  - ç) ngjyrë e zezë;
  - d) përmbajtje nitrat argjendi 20%;
  - dh) e padëmshme për organizmin;
  - e) e pa cënueshme nga agjentë atmosferikë.



## LIDHJA 2

### Modeli I



#### **Specifikimet:**

Lartësia: 150 cm  
Lartësia e mbajtëses: 105 cm  
Përmasat e suprinës:  
Gjerësia: 54 cm  
Thellësia: 60 cm  
Materiali:  
Karton trashësia 5mm (5 shtresa)

#### **Karakteristika:**

Rezistente ndaj lagështirës  
E palosshme

### Modeli II

(dhoma e fshehtë e përshtatur për zgjedhësit më aftësi të kufizuara)



#### **Specifikimet:**

Lartësia: 80 cm  
Përmasat e suprinës:  
Gjerësia: 60 cm  
Thellësia: 50 cm  
Materiali:  
Karton 5mm (5 shtresa)

#### **Karakteristika:**

Rezistent ndaj lagështirës  
E palosshme

**Kartoni i dhomave të fshehtësisë është i bardhë.**

**Në pjesën ballore stampohet stema e Republikës së Shqipërisë.**

**Të vendoset logo zyrtare e KQZ-së në pjesën ballore të saj.**